



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
GRUPI I PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN E ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMI

Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit: “Shpallja e zonës me përparësi zhvillimi”

Propozuesi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Punës.

Sqarime për projekt-aktin: Ky projektakt ka për qëllim të shpall zonat zhvillimore brenda territorit të Bashkisë Elbasan sipas ligjit nr. 20/2025 “Për Paketën e Maleve”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet sipas kalendarit të konsultimeve.

Pjesëmarrës:

Nga ana e Bashkisë: Shpëtim Çullhaj, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave, Grupi i punës i ngritur me qëllim shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi brenda territorit të Bashkisë Elbasan, Administratori i njësisë respektive sëbashku me stafin profesional dhe Kryepleqte e fshatrave të asaj Njësie Administrative.

Nga komuniteti: Banorë të zonës pretendues për tu shpallur posedues jopronar për zonën e propozuar për zhvillim, subjekte të ndryshëm që kanë qëllim zhvillimin e zonës në fjalë nëpërmjet investimeve të ndryshme, etj.

Format e konsultimit: Tryeza diskutimi/Takime publike

Qëllimi i konsultimit publik	Grupi i punës për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi i ngritur me urdhërin nr.454, datë 27.06.2025 për zbatimin e procedurave të parashikuara në Udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në teritoret e bashkive”, bazuar në ligjin nr.20/2025 “Për paketën e maleve”, neni 4 dhe ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ka për qëllim të garantojë pjesëmarrjen e komunitetit në vendimarrje si dhe të organizojë konsultime publike duke marrë parasysh mendimin e komunitetit përgjatë procesit të konsultimit duke i përfshirë ato në draftin e propozuar nga Grupi i Punës me qëllim shpalljen e zonës prioritare që do të propozohet për zhvillim dhe do të ketë impakt pozitiv mbi mirëqenien e jetesës së tyre në të ardhmen. Ky takim shërben për të marr mendimin e gjithë secilit që është i prekur nga shpallja e zonës me përparësi zhvillimi dhe
------------------------------	--

	konkludimin në fund për propozimin e hartës përfundimtare që do të krijohet për shpalljen e zonës.
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr.20/2025 “Për paketën e maleve” dhe Udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në teritoret e bashkive” në projekt-akt trajtohen çështjet e mëposhtëme: a) identifikimi dhe hartëzimi i zonës së zhvillimit brenda territorit të Bashkisë Elbasan në përputhje me parashikimet e nenit 3, shkronja ç) e ligjit nr.20/2025 “Për paketën e maleve” dhe evidentimi në terren për të verifikuar gjendjen faktike të posedimit, për të cilën mbahet procesverbali përkatës. b) analizimi i të gjithë të dhënave të nevojshme socio-ekonomike, mjedisore dhe gjeografike si dhe çdo dokumentacioni tjetër që mund të jetë i nevojshëm në kuadër të kësaj analize, përfshirë edhe kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme në platformën dixhitale. c) ndërveprimi dhe bashkëpunimin me drejtorinë përkatëse vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për verifikuar statusin e pronës të poseduar nga poseduesit jopronar në atë pjesë të territorit që synohet të shpallet zonë zhvillimore. ç) bashkërendimi dhe bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për të siguruar dhe nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të zonës së zhvillimit d) vlerësimi i përputhshmërisë me dokumentet ekzistuese të politikave dhe planeve vendore të tilla si plani i përgjithshëm vendor, plani vendor i menaxhimit të pyjeve apo çdo dokument tjetër të ngjashëm. dh) vlerësimi dhe konfirmimi se zona e zhvillimit e propozuar nuk përfshin teritore që janë pjesë e mosmarrëveshjeve midis bashkive kufitare, në lidhje me hartën e miratuar për territorin e bashkisë përkatëse dhe ndarjen administrativo-territoriale, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në territorin në fjalë nuk janë të ndaluara zhvillimet ndërtimore në bazë të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

Pyetjet që ngre Grupi i Punës ndaj publikut	1. Si e gjykoni propozimin për shpalljen e zonës prioritare të zhvillimit sipas kësaj planvendosje (shpjegon planvendosjen me kufinje të qartë terreni)? 2. A mendoni se ka mjaftueshëm posedues jopronar për zonën e propozuar nga ana jonë në bashkëpunim me ju (referuar edhe shprehjeve të intresit që keni shpreh në sistemin online)? 3. Çfarë sugjerimesh do të kishit ju, për ndryshim të kufinjëve të shpalljes së zonës së zhvillimit dhe aktivitetet e mundëshme/synuara për zhvillim të zonës? 4. Sa posedues jopronar mendoni që përfshinë kjo zonë e propozuar? 5. Si paraqitet niveli i kërkesave për zhvillimin e turizmit por jo vetëm (lokale dhe ndërkombëtare)?
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim	Grupi i punës për identifikimin dhe shpalljen e zonave të zhvillimit, nëpërmjet koordinatorit për konsultimin publik do të bëjë publik kalendarin e konsultimeve. Administrata e bashkisë do të lehtësojë komunikimin me qytetarët dhe grupet e interesuara. Do të vihet në dispozicion një adresë e-mail ku do të dërgohen rekomandimet e qytetarëve.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve	Kontaktet ku do të dërgohen rekomandimet janë: Koordinatori i Këshillit Bashkiak: Alba Papa, E-Mail: alba.papa@elbasani.gov.al Grupit të punës për identifikimin e zonave me përparësi zhvillim kryesuar nga N/Kryetari i Bashkisë, z. Asim Sula, E-Mail: asim.sula@elbasani.gov.al dhe antari i grupit të punës z. Xhulian Muça, E-Mail: xhulian.muca@elbasani.gov.al
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Studim “Mbi potencialin dhe zhvillimin e zonave me përparësi zhvillimi në Bashkinë Elbasan”. Projektakti për identifikimin e zonës duke marr parasysh të gjithë faktorët përkatës të shtjedhuar në udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në teritoret e bashkive”. Hartat e zonave të propozuara. Raporti mbi infrastrukturën përkatëse dhe nevojat për investime infrastrukturore. Relacioni mbi projektaktin e propozuar.
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Grupi i Punës siguron reagim ndaj komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve të dërguara nga publiku apo grupet e interesi për projektaktin/ zonën zhvillimore të shpallur për këshillim publik, përgjatë gjithë fazave të procesit të këshillimit publik. Në varësi të numrit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve, Grupi i punës, nëpërmjet antarit të sipërcituar i dërgon konfirmimin e marrjes së tyre të gjithë dërguesve: me poste elektronike

	(individualisht) ose me poste te rregullt përgjigje kolektive (me poste).
Data e publikimit	05.08.2025 Elbasan Koordinatori i konsultimeve publike